- mungon modeli ne secilin artikull te ofruar
- mungon pesha e pllakes se ofruar
- mungon pesha e jelekut me balistike
- mungon informacioni per madhesite e jelekut siç jane kerkuar ne Aneksin 1.

te gjitha keto jane elemente pa te cilat nuk mund te identifikohet artikulli e aq me pak te vleresohet, andaj shihet se Konsorciumi i rekomandUar per kontrate nuk ka plotesuar piker' e kerkuar, njeherit nga keto specifika as teorikisht nuk mund te determinohet pesha totale e produktit te ofruar e qe eshte njeri nder kriteret e specifikimeve teknike.

Konstatimi 3:
Autoriteti kontraktues ne nenin 9.1 pika 4 te FDT ka kerkuar
Certifikate dhe Raportin testues laboratorik per nivelin e mbrojtjes NIJ-IV (4) per pllaken e artikullit 2 (antiplumbi i jashtem).
Konsorciumi i rekomanduar per kontrate ka dorezuar 3 test raporte per pllake me numrat e test raporteve 07MB04750, 0Th/1B0451 dhe 07N1B04752 dhe nga ato shihet kjarte se pllaka e testuar ka keto karakteristika:

- Dimensioni eshte: 300x250mm
- Trashesia eshte: 18.69mm
- Pesha per testin 07MB04750 eshte: 3065 gram
- Pesha per testin. 07MB04751 eshte: 3075 gram
- Pesha per testin 07MB04752 eshte: 3063 gram
- Deri 3075 gram

Njeherit OE i rekomanduar per kontrate ka dorezuar "katalogun" pe rNIJ IV, me titull: HARD AMOUR PLATE ku shihet se:

- Trashesia e pllakes se ofruar eshte 23 mm
- Nuk ka ofruar fare peshen e pllakes (gjë që eshte determinuese per kriterin e peshes se jelekut)

nga ketu shihet se test raportet e ofruara nga OE i rekomanduar per kontrate fare nuk perkasin me katalog dhe me produktin e ofruar, qe i bie se OE i rekomanduar per kontrate nuk ka fare test raportet per produktin te cilin e ka ofruar, sepse testet e ofruara jane per produkt krejtesisht tjeter.

Konstatimi 4

Tek Aneksi 1 te specifikat e detyrueshme eshte kerkuar qe duhet te plotesohet Specifikacioni I ofruar nga OE (perfshire Brendin dhe MOdelin)
Konsorciumi i rekomanduar per kontrate nuk ka plotesuar fare Modelin, njeherit te gjitha specifikimet e tjera i ka kopjuar nga kerkesa e AK-se duke kopjuar cdo shkronje perfshire edhe rreshtin informativ "Design: Similar ëith attached photo (source internet)"

Nga se u tha me larte, konstatimi 1-4, konsiderojme se AK nuk e ka bere vleresimin e tendereve ne perputhshmeri te kritereve te vendosura ne Dosjen e tenderit dhe si rrjedhoje ka bere shkelje te:

- *Nenit 7 "Brazia tie trajtint dhe jo-diskriminimi"* te LPP-se, sepse ka favorizuar konsoreiumin "Allzone SHPK, Seyntex SA dhe PROCPM" pasi ge ka Operblyer me kontrate SE te papergjedshem;
- *Nenit 56, paragrafi _1.1 "ISispozitat e Pergjithshnte inbi Perzgjedhjen e Pjesentarresve dhe Shënien e Kontrat ve"* te LPP-se, pasi që perkunder faktit se Konsoreiumi ne fiale nuk ka plotesuar specifikimet minimale te pereaktuara ne Dosje te tenderit, te njejtin ka shperblyer me kontrate;

Nenit 59, paragrafi 4 " Ekzaminina, Vleresimi dhe Krahasirni i Tendereve" te LPP-se, pasi qe ne perputhje me kete nen, Autoriteti kontraktues do te konsideroj niëtender site nergiegishem vetem nese tenderi ne fjaie eshte ne perputhshmeri me te ,gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontrates; dhe ne dosjen e tenderit, •ndersa Konsorciumi i -shperblyer me kontrate ka dorezuar tender jo ne, perputhshmeri mete.gjitha kerkesat e parashtruara.

a) Mostrat e ofruara nuk perputhen me pershkrimin dhe prezantimet e produkteve qe duhet te furnizohen, mege ne moster eshte ofruar tjeter artikull ndersa me pershkrinte tj eter, dhe

b) Certifikatat e hartuara nga institutet zyrtare per kontrollimin e eilesise ose agjencite kompetente te pranuara që vertetojne pershtatshmerine e produkteve jane ofruar per produkte tjera nga ato te cilat jane sjelle si mostra per vleresim, njeherit nuk perputhen as me kataloget e ofruar dhe rrjedhimisht konsiderojme se AK ka shperfillur Nenin 59.4 te LPP-se.

Nenit 60, paragrafi 1.1 "Kriteret per Dhenien e Kontrates" te LPP-se, pasi qe ne perputhje me kete nen, Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontraten publike operatorit ekonomik qe ka dorezuar tenderin e pergjegjshem me cmimin me te ulet, ndersa AK ka shperblyer me kontrate Konsorciumin qe ka dorezuar tender te PAPERGJEGJESHEM.

Konstatimi 5.

Anetari i konsorciumit, kompania Seyntex SA, nuk ka dorezuar deshmine epershtatshmerise profesionale sic kerkohet ne FDT tek Kerkesat e pershtatshmerise profesionale neni 7.2 pika 1 - Kopja e certifikates se regjistrimit te biznesit, dhe e parapare me *Nenin 66.1 te LPP-se.*
Citoj: "Kur nje operator ekonomik qe kerkon te merr pjese ne nje aktivitet te prokurimit ose ne Permbushjen e kontrates publike duhet te regjistrohet Tie regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndermarrjeve ne menyre qe të zbatoje aktivitetet per te cilat nje regjistrim i tillë kerkohet, autoriteti kontraktues mund te kerkoje nga operatori ekonomik qe të paraqese dokumentin e leshuar nga autoriteti perkates publik ne vendin e themelimit te operatorit ekonomik me te cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik ne ate vend..." dhe si rrjedhoje ka bere shkelje *te nenit 71,*

paragrafi 4, "Grupet e Operatoreve Ekonomik dhe Operator& e Huaj Ekonomik" pasi qe ne perputhje me kete nen cdo kerkese e vendosur sipas nenit 66.1 duhet te plotesohet nga secili anetar i grupit.

Konstatimi 6:
Anetari i konsorciumit, kompania Seyntex SA, ka dorezuar disa dokumente ne gjuhen Belge dhe nuk ka per to perkthim zyrtar te vertetuar nga perkthyesit e licencuar ne njeren nga gjuhet zyrtare te Republikes se Kosoves dhe si rrjedhoje AK ka bere shkelje te nenit 13.4 *"Perdorimi i gjuheve ne dokumentet e prokurimit publik"* pasi qe ne perputhje me kete nen *"Nje operator ekonomik mund te paraqese nje tender, nje kerkese per pjesemarrje apo ndonje dokument t jeter te kerkuar apo qe lejohet te plotesohet gjate aktivitetit te prokurimit, ne gjuhen Shqipe, Serbe .ose ne gjuhen Angleze"*

Konstatimi 7:
AK ne FDT tek nenin 3.1, Specifikacionet teknike te detyrueshme ne piken a) ka kerkuar:
Deklaraten per specifikacionet teknike per mallrat e ofruar te cilat perputhen me ato te permendura ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit.

Konsorciumi i rekomand.uar me kontrate **NUK** ka paragitur fare Deklaraten e kerkuar sipas FDT-Se.

Megjithate, me dt. 02.12.2016 AK ka kerkuar nga Konsorciumi ge kriterin e parapare me Nenin 3.1 te FDT-se (Deklaraten per Specifikacione teknike) te e dorezoje me se voni me dt. 07.12.2016. Ky veprim nuk parashihet me LPP-ne per tenderat e doreZuar fizikisht, sic ka (lend rasti i tenderit ne fjale dhe ekzistojne praktika te mira te Vendimeye te OSHP-se kur pikerisht per mungese te Deklaraten per Specifikacione teknike OE fitues eshte shpallur nga Vendimi i OSHP-se si i papergjegjshem. Ju lutem referojuni vendimit Le OSHP-se 143/16 ku nje OE eshte diskualifikuar pikerisht per mungese te Deklarates per Specifikacione teknike.

Konstatimi 8
AK ne FDT por decidivisht ne Aneksin 1 - Specifikacionet teknike ka kerkuar:
Garandoni 10 vite per stab protection.
Garancioni i ofruar nga Konsorciumi i rekomanduar per kontrate nuk e ka te perfshire garancionin per **stab protection (mbrojtje kunder therrjes)**
Nga se u tha me larte, konstatimi 7-8, konsiderojme se AK nuk e ka bere vleresimin e tendereve ne perputhshmeri te kritereve te vendosura ne Dosjen e tenderit dhe si rrjedhoje ka belt shkelje te Nenit 59, prsigrafi 4 "Ekzaminimi, Vieresimi dhe Krahasimi i Tendereve".

GJATE **PROCESIT** TE RIVLERESIMIT, RAPORTI I TE CILIT KA PERFUNDUAR NGA KOMISIONA VLERESUES PREJ TRE ANETARESH ME DT. 14.11.2016 (SHITEI FAQEN E PARE TE RAPORTIT), AK KA VAZHDUAR QE TE JUSTIFIKOJE DHE NXJE TE PE GjEGJSITEM KONSO CIUMIN DUKE KERKUAR KESHTU INFORMACIONE SHTESE E ILE ME DATE 07.12.2016, VEPRIM KY NE KUNDE SHTIM TR PLOTE ME LPP-NE, RESPEKTIVISHT NENIN 41 I UOPP-SE - EKZAMINIMI, VLERESIMI DUE KRAHASIMI I TENDEREVE.
PAS PERFUNDIMIT TE VLERESIMIT AK KA KIR KUA NGA K NSO CIUMI QE TE SJELLE EDITE DOKUMENTIN "DEKLARATE PE SPECIFIKINCE TEKNIKE KON FORM KERKESES SE DT-SE. POASHTU KY AVAZ I KOMPLETIMIT TE DOSJES St TENDERIT TE KONSOCIUMIT FITUES KA VAZHDUAR EDRE NE MUAJIN III IJETOR DUKE KERKUAR NGA KETA TE FUN IT E HE PERSHTATSHMIE TE PRODUKTIT UHE PESHES SPEC1FIKE TE JELEKEVE.

SHENIM ME RENDES!:
GJATE MATJES SE jELEKUT TE JASFITEM ALISTIK TE KONSORCIUMIT GjATIE QASJES NE JOKUMENTE TE TENDE IT PAS RIVLERESIMIT ESIITE KONSTATUAR SE MUN4 TE JETE NDRYSHUA . MOSTRA, PERFSHIRE PANELET ALISTIKE TIE BRENDSHME DHEPLLAKAVE BALISTIKE JELEKU ME GJITHE PLLAKA KA PESHUAR **8.05KG** GJATIE MATHS SE PARE (DESHMITE E TE CILAVE JU KEMI PREZANTUAR EDHE GJATEANKESES SE PARE) PER DERI SA MATJA E TANISHME REZULTON TE JETE 7.68 KG (SHIH DESHMIN AKTUALE)

PRETENDIMET LIDHUR ME OPERATORIN EKONOMIKPOLIGONI I SHENJTARISE KATANA

Gj ate qasjes ne dokumente te tenderit patem mundesine qe te evidentojme edhe shkelje per sa i perket OE, qe sipas Raportit te vleresimit del te jete i pergjegjshem, duke perfshire te pakten keto shkelje:

1. AK ne FDT por decidivisht ne Aneksin 1 - Specifikacionet teknike ka kerkuar: **Garanci 10 vite per balistike dhe stab protection.**

   Garancioni i ofruar nga OE Katana nuk e ka te perfshire garancionin per stab protection **(mbrojtje kunder** therjes) por vetern per panelet balistike dhe pllakave balistike (citoj: "Ëe do herby certify that the ballistic performanca of the ballistic inserts and plates are ëarranted for the period of 10 years from the date ofpurchase...")
2. OE Katana lidhur me Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesinale, Neni 9.1 dhe 9.2, gjegjesisht kerkeses 6. Certifikate per nivelin e mbrojtjes nga shpimet niveli KR1 per artikullin 1 (anti plumbi i brendshem) ka dorezuar raportin e testimit Nr. 14S267-02#, por jo Certifikaten per nivelin e mbrojtjes nga shpimetniveli KR1.

Si rrjedhoje, AK duhet te eliminoje tenderin e OE Katana, ngase nuk.i ploteson dispozitat e siperpermendura te LPP-se.

Dëmet Materiale

Dernet materiale tejkalojne vleren prej 200,000.00 Euro, pa llogaritur deme te konsiderueshme materiale per shkak te fitirnit te humbur dhe duke mos perfshire konsuleneen profesionale dhe te angazhimeve shtese per grumbullimin e informatave lidbur me perpilimin e kesaj ankese.

Propozim

Per me shume konsiderojme se kompania jone ka plotesuar ne teresi kriteret e parapara ne dosje te tenderit, dhe njeherit ka ofruar cmimin me te lire nder ofertat e pergjegjshme ne kete aktivitet te prokurimit, andaj kerkojme nga Autoriteti Kontraktues qe:

1. **Te aprovoj ne teresi kerkesen tone per Rishqyrtim konform Nenit 108A te Ligjit nr. 041L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 041L-237, ligjin Nr. 051L-068 dhe ligjin Nr. 051L-092.**
2. **Te anuloj njoftimin per dhenje te kontrates.**
3. **Aktivitetin ne fjale ta kethej ne Ri vleresim.**
4. **Te shpalle fitues kompanine tone si operatori ekonomik me i lire nder OE te pergjegjshem**

Procesi i prokurimit

Data e njoftimit për kontratë(N.40) :	27.07.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16):	furnizim/e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	29.07.2016 ora 14ºº

Data e hapjes së ofertave (N.58) -	29.07.2016 ora 14³º
Data e njoftimit për dhenie te kontrates	31.03.2017

III.2 KUSHTET PËR PJESMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
2. Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.
3. Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit – Aneksi
2. Vërtetim nga Administrata Tatimore
3. Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – origjinal / kopje e noterizuar.

Dokumentet (nën 2 dhe 3) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështim në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me procedura te tjera konform LPP-se.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës)
2. Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore)
3. Certifikata e numrit fiskal (vetëm për kompanitë vendore)
4. Autorizimi nga prodhuesi për shitje (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë)
5. Certifikatë/licencë për tregti me PQV (nëse janë ne grup se paku njeri anëtar i grupit duhet te ketë licence për PQV)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit te biznesit
2. Kopja e certifikatës së TVSH-së
3. Kopja e certifikatës së numrit fiskal
4. Autorizimi nga prodhuesi për shitje (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë) - origjinal/kopje e noterizuar
5.Licenca apo certifikata për tregti me PQV

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Qarkullim financiar, për tri vitet e fundit, se kompania ne fjale ka bere qarkullim ne vlere prej min 3.000.000,00 euro

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Raporti apo dëshmia financiare nga një Banke.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Katalog apo broshure me ilustrime dhe foto me te cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike te ofruara.
2. Prodhuesi duhet te jete i certifikuar me standardin ISO 9001
3. Mostra për secilin artikull

4: Certifikate dhe Raportin testues laboratorik për nivelin e mbrojtjes NIJ-IV (4) për pllakën e artikullit 2 (anti plumbi i jashtëm)

5: Certifikate dhe Raportin testues laboratorik NIJ-IIIA (3A) për pjesën e bute balistike për te dy artikujt

6. Certifikatë për nivelin e mbrojtjes nga shpimet niveli KR1 për artikullin 1 (anti plumbi i brendshëm)

7Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te njëjta apo te ngjashme gjate 3 (tri) viteve te fundit (2013,2014 dhe 2015) jo me pak se 2 referenca

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Katalogu/apo broshure me detaje te mjaftueshme për vlerësim
2. Certifikata 9001- kopje
3. Mostrat
4. Certifikatë dhe raport testues laboratorik NIJ-IV (4) - kopje
5. Certifikatë dhe raport testues laboratorik NIJ-IIIA (3A) - kopje
6. Certifikatë për nivelin e mbrojtjes min KR1- kopje
7. Listën e kontratave te njëjta apo te ngjashme të nënshkruar dhe realizuara me suksese 3 vitet e fundit (2013,2014 dhe 2015). **Duhet të dorëzohet ne origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.**

Dëshmitë:

Min 2 Referencat / raport te pranimit sipas listës se kontratave te prezantuara për furnizimet te njëjta apo te ngjashme gjatë tre viteve te fundit

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Emri i Tenderuesit	Vendi	Çmimi € Lot2	Vërejtje
1	" Liria – 2 Shpk & Groteks Shpk"	Prishtinë	2.197.398,00	jo
2	Ntsh "Lenti"	Prizren	1.886.796,00	jo
3	"Reload"	Prishtinë	2.015.107,20	jo
4	**All Zone & Seyntex Sa & Proccm ShPK**	Prishtinë	**1.591.800,00**	jo
5	**Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana"Sh.P.K**	Obiliq	2.272.266,00	jo
6	**"Sodex Group" SH.P.K**	Prishtinë	2.094.840,00	jo

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se ne hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi. Nuk ka pasur vërejtje për procesin e hapjes se ofertave nga asnjë operator ekonomik. Raporti i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes dhe përfaqësuesit e operatorëve ekonomik te pranishëm.

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60):..... Tenderi i përgjegjshëm **Çmimi më i Ulët**

Komisioni vlerësimit pranë AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).
Autoriteti Kontraktues për ri vlerësimin e tenderëve ka formuar komisionin me vendimin te datës 14.11.2016 në përbërje prej tre anëtarëve:

1. Besart Ahmeti– Kryetar i Komisionit
2. Adem Ribari - Anëtar
3. Azbije Krasniqi – Anëtar

Data e mbarimit të vlerësimit të ofertave:.....21.03.2017
Data e e nënshkrimit nga zyrtari i prokurimit.....27.03.2017

Raporti i komisionit vlerësues

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës për:

"All Zone & Seyntex Sa & Proccm ShPK " me ofertën në vlerë prej **1.591.800,00 €.**

Komisioni vlerësues ka konstatuar dhe vlerësuar si në vijim:
Operatoret që kanë ofertuarjanë6(gjashte)
Operatoret ekonomik të përgjegjshëmjanë 2
Operatoret ekonomik të pa përgjegjshëm janë4

Deklarata e komisionit vlersues

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit tëofertave konkuruese ka ardhe ne perfundim se ne kete projekt jane pranuar 6 (gjasht) oferta prej te cilave 2 jane te pergjegjehme.

Rishqyrtimi i kërkesës nga Autoriteti Kontraktues

E datën 07.04.2017, autoriteti kontraktues ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga OE**"Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K" Sh.P.K**dhe**OE "Sodex Group" SH.P.K** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me jelek Anti -Plumb"** me nr.prokurimi AP 214/16/134/111. Llidhur me kete kërkesë Autoriteti kontraktues me datën **13.03.2017**mori këtë:

Vendim

Refuzohet si e pa bazuarkërkesa e OEOE **"Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K" Sh.P.K**dhe **OE "Sodex Group" SH.P.K** llidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me jelek Anti -Plumb"** me nr.prokurimi AP 214/16/134/111.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues/teknik (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës së Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kan pasur në dispozicion ekspertet shqyrtues-teknik japin mendimet si në vijim:

Konstatimi: Nr. 1

Ky aktivitet i prokurimit është publikuarnga autoriteti kontraktues me procedurë të hapur. Lloji i kontratës është furnizim, kontratë publikeme vlere te madhe.Në dosjen e tenderit janë dhënë informata përkatëse lidhur me kontratën në fjalë.

Dosja përfshinë të gjitha termet dhe kushtet materiale të sajë, procedurat e zbatueshme të prokurimit, kërkesa të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes. Kriteri i dhënies së kontratës është në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Konstatimi nr. 2

Gjatë shqyrtimit të kësaj lënde, Eksperti shqyrtues/teknik në përputhje me nenin 113 pika 1 të LPP-së, japin mendimin për pretendimet ankimore të OE ankues si në vijim.

Pretendimi ankimor i OE ankues **Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K**se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar **nenin 6**të LPP-së sepse gjatë vlerësimit ka vendos ti jepet tenderi konzorciumit i cili nuk ka dëshmuar qartë përputhshmërin me kërkesat e dosjes së tenderit për mendimin e ekspertëve ky pretendim nuk korospodon me shkleje të nenit 6 sepse ky nen nuk i dedikohet përputhshmërisë së kërkesave të dosjes së tenderit me ofertëat e tenderuesve por ekonomicitetit dhe efikasitetit të ofertave. Prandaj si i tillëështë i **pa bazuar**.

Pretendimi tjetër ankimor i OE ankues në fjalë se autoriteti kontraktues ka shkel **nenin 7** të LPP-së duke e shpallë fitues konzorciumin që ka ofruar dokumente, vërtetësia e të cilave është refuzuar nga instituti dhe në këtë mënyrëështë favorizuar konzorciumi fitues, ekspertet shqyrtues-teknik mendojnë se është pretendim **pjesërisht i bazuar**. Qëndron konstatimi se është rekomanduar për kontratë ofertuesin vërtetësia e dokumenteve të tijë nuk ka qenë e saktë sipas institutit, mirëpo në të njëjtën mënyrë ka vepruar edhe me ofertën e OE ankues **Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K** të cilin e ka vlersuar si të përgjegjshëm edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, prandaj barazia në trajtim ka qenë e njëjtë. Ka toleruar dobësi për të dy operatorët ekonomik dhe ka vendosur për oferttën më të ulët.

Pretendimi ankimor i OE ankues në fjalë se autoriteti kontraktues ka shkel **nenin 59** të LPP-së për shkak se konzorciumi fitues nuk i plotëson substancialisht kërkesat e specifikuara në dosjen e tendrit për mendimin e eksperteve shqyrtues-teknik ky pretendim **qëndron**.

Gjatë vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktues ka shpallë të përgjegjshëm konzorciumin fitues edhe pse i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat teknike të dhënë në specifikacionin teknik në dosjene tenderit.

Po ashtu në aspektin teknik nuk është vlersuar drejtë as Operatori ekonomik ankues **Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K** sepse është shpallë i përgjegjshëm edhe pse nuk i ka ofruar të gjitha çertifikatat për produktet e ofruara të cilat janë kërkuar në dosjen e tenderit.

Gjithashtu raporti i vlerësimit ka mos përputhje në mes të pjesës së para në plotësimin e tabelave me "po /jo" të cilat konfirmojnë plotësimin e kërkesës ose jo. Në rastin konkret për OE ankues **"Sodex Group" SH.P.K** i cli është shpallë i **pa përgjegjshëm** në raportin vlersues të gjitha kërkesat në tabela janë plotësuar me "po". Ndërsa në fund të raportit vlersues evidentohet si i pa përgjegjshëm dhe i përmenden kërkesat e specifikimit teknik të pa plotësuar.

Pretendimi tjetër ankimor i OE ankues **Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K** se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje tënenit **60** të LPP-së për shkak se se ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të pa përgjegjshëm me çmim më të ulët. Për mendim e ekspertëve ky pretendim **qëndron**.
Ky nen përcakton që AK do ti jap kontratën OE që ka dorzuar tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët, ndërsa në rastin konkret OE i rekomanduar për kontratë ka qenë i pa përgjegjshëm.

Pretendimi tjetër ankimor i OE ankues **Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K** se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të **nenit 64** të LPP-së për shkak se ka shpallë fitues OE që nuk ka dëshmuar përshtatshmërin profesionale sepse nuk ka përvojë në këtë fushë dhe ka dorzuar projekte të ndërtimit për mendimin e ekspertëve ky pretendim **nuk qëndron**. Autoriteti kontraktues nuk i ka marrë për bazë projektet e ndërtimit të ofruara nga konzorciumi fitues gjatë fazës së vlerësimit për plotësimin e kërkesave të dosjes së tenderit.

Pretendimi tjetër ankimor i OE ankues **Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K** se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të **nenit 67** të LPP-së sepse nuk ka vërtetuar provat shkresore sipas vendimit të OSHP-së. Ekspretet shqyrtues-teknik mendojnë se ky pretendim është i **pa bazuar**. Autoriteti kontraktues ka zbatuar vendimin e OSHP-së sepse ka bërë rivlersimin e ofertave por edhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shtesë për aq sa lejohet me ligj.

Pretendimi fundit ankimor i OE ankues **Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K** se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të **nenit 69** të LPP-së lidhur me aftësit teknike dhe/ose profesionale sepse ka pranuar referenca e konzorrciumit si të vlefshme të lëshuar nga njëri antar në komzorcium që është edhe prodhues i produkteve si dhe e ka vlersuar teknikisht në rregullë ofertën e konzorciumit fitues edhe pse nuk i ka ofruar specifikimet teknike të produkteve që ka ofertuar, ekspertet shqyrtues/teknik e vlerësojn si pretendim **pjesërsiht të bazuar**.

Ekspertet mendojnë se referencat e dorzuara nga konzorciumi fitues janë të pranueshme dhe e plotësojnë këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Ndërsa ekspertët konstatojnë se oferta e konzorciomit fitues nuk i ka plotësuar kërkesat tjera të dosjes së tenderit që lidhen me çertifikatat dhe raportet e testimit për produktet e ofruar.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk i ka ofruar këto të dhëna:

- Nuk ka përshkrim teknik për produktin e ofruar në pjesën e specifikimit teknik që është dashur të plotësohet. Nuk dihet sipas specifikimt teknik qfarë produkti është ofruar.
- Nuk janë dhënë çertifikatat për konformitetin e produktit te "jelekët e jashtëm" por janë dhënë vetëm raportet e testimit.
- Raportet e testimit nuk e përcaktojnë llojin e produkti që është dhënë në katalog.
- Çertifikata për nivelin e mbrojtjes nga shpimet niveli KR1 nuk i përgjigjen produktit të ofruar në katalog por një produkti tjetër.

Të gjitha këto çështje janë esenciale për furnizim me produktet e kërkuar dhe ngritjen e nivelit të sigurisë së mbrojtjes së policëve nga ana e autoriteti kontraktues.
Mungesa e këtyre të dhënave teknike e bënë të pa përgjegjëshme ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Konstatimi nr. 3

Lidhur me pretendimet ankimoretë operatorit ekonomik ankues**"Sodex Group" SH.P.K**për shkelje të dispozitave të LPP-së nga ana e autoritetit kontraktues ne do të japim mendimin në përgjgjëjevet vijuese.

Pretendimi ankimor i OE ankues **"Sodex Group" SH.P.K** se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të **nenit 7** të LPP-së, ekspertet shqyrtues-teknik dhanë mendim në konstatimin paraprak për shkelje të kësaj dispozite nga ana e autoritetit kontraktues. Për këtë pretendim ankimor, operatori ekonomik ankues në fjalë nuk ka dhënë një përshkrim të qartë për arsyet e shkeljes nga ana e autoritetit kontraktues.

Pretendimi tjetër ankimor i OE ankues **"Sodex Group" SH.P.K** se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të **nenit 56** të LPP-së për mendimin e eksperteve shqyrtues-teknik ky pretendim **pjesërisht qëndron.** Vlerësimi i tenderëve dhe kandidatëve nuk është bërë në përputhje të plotë me kriteret e përzgjedhjes dhe specifikimeve teknike të dhëna në dosjen e tenderit. Kjo për faktin se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Sa i përket Deklaratës së Specifikimeve teknike që konzorciumi fitues e ka ofruar si dokumentacion shtesë, ekspertet vlerësojn se kjo është e pranueshme dhe lejohet qe nese praprakisht është dorzuar katalogu me ofertë.
Në rastin konkret fituesi katalogun e ka dorzuar me ofertë ndërsa deklartën e specifikimeve teknike e ka dorzuar si dokumentacin shtesë. Neni 39 "Sqarimi i Tenderëve" i Udhzuesit OperativtëProkurimit Publik e lejon një veprim të tillë.

Pretendimi ankimor i OE ankues **"Sodex Group" SH.P.K** se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të **nenit 59** të LPP-së, për mendimin e ekspertëve shqyrtue-teknik **qëndron**. Mendimi për shkeleje të kësaj dispozite është dhënë në konstatimin paraprak.

Pretendimi tjetër ankimor i OE ankues **"Sodex Group" SH.P.K** se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të**nenit 60** të LPP-së, për mednimin e ekspertëve shqyrtues-teknik qëndron. Përgjigjëja është dhënë në konstatimin nr.2.

Pretendimi vijues ankimor i OE ankues **"Sodex Group" SH.P.K** se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të **nenit 71** të LPP-së që lidhet me grupet e operatorëve ekonomik dhe operatorët e huaj ekonomik e që në rastin konkret ka të bëjë me konzorciumin fitues, ekspertet shqyrtues/teknik mendojnë se ky pretendim **nuk qëndron**. Konzorciumi fitues i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit për formim të grupit.

Pretendimi ankimor i OE ankues **"Sodex Group" SH.P.K** se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të **nenit 13** të LPP-së për shkak se ka ofruar dokumentet zyrtare që janë në gjuhën belge me përshtatje të tekstit por nuk ka ofruar përkthim zyrtar në origjinal.

Ekspertet shqyrtues-teknik lidhur me këtë pretendim mendojne se dokumentet e tenderit për kontrata të mëdha si rregull duhet të janë në dy gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze. Meqense vetëm disa dokumente janë në gjuhën belge dhe jo të gjitha, atëherë ky pretendim **pjesërisht qëndron**.

Pretendimi i fundit ankimor i OE ankues **"Sodex Group" SH.P.K** se autoriteti kontraktues e ka shpallë të përgjegjshëm OE ankues **Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K** edhe pse ky nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit për mendimin e ekspertëve shqyrtues-teknik ky pretendim **qëndron**.

Ky ofertues **nuk a ka ofruar** në dosjen e tij **Çertifikatën për nivelin e mbrojtjës nga shpimet KR1.** Prandaj në aspektin tekniko profesionale edhe operatori ekonomik ankues **Ploigoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K** është i **pa përgjegjshëm.**

Nga këto që u thanë më lartë vijmë në përfundim se asnjëri nga operatorët ekonomik të shpallur si të përgjegjshëm nga autoriteti kontraktues **nuk i kanë plotësuar** të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Prandaj konstatojmë se anjë operator ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit **nuk është i përgjegjshëm**.

Ne fund te sqarimeve te dhena ekspertet shqyrtues –teknik sqarojn se pas vendimit te Panelit shqyrtues per ri-vleresim te këtij aktiviteti te prokurimit, AK-ja i ka derguar mostrat ne laborator te Forenzikes, e cila nuk i ka ekzaminuar me arsyetimin se jane te nevojshem edhe disa mostra – jelek antiplumb, me saktësisht i ka kërkuar nga 6 Jelek per secilin OE. Prandaj, duke u nisur edhe nga ky fakt ekspertet vleresojn se ekzaminimi i mostrave eshte i pamundur sepse AK-ja e ka kerkaur vetem nja nje moster. Andaj, ekspertet shqyrtues- teknik i rkeomandojn AK-Policise se Kosoves ne kete rast meqenëse nuk ka OE te pergjegjshem ateher me rastin e Ritenderimit te kërkoj edhe numrin e nevojshem per ekzaminimin e mostrave sepse testimi i tyreeshte nje veprim i cili e ngrit sigurin e pjesetareve te plocise se Kosoves.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

Me rastin e rivlerësimit të ofertave nga autoriteti kontraktues, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e neneve 7, 13, 56, 59, 60 dhe 69 të LPP-së.

Përgjigje në pikat e ankesës

Përgjigjeje për pikat e ankesës janë dhënë në konstatimet e lartshënuara.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Eksperti shqyrtues-tekniki vlerëson si **pjesërisht të bazuara,** ankesat e OE ankues **Poligoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K** dhe OE **"Sodex Group" SH.P.K**.
Bazuar në gjitha konstatimet dhe sqarimet e dhënagjatë shqyrtimit të kësaj lënde, eksperti shqyrtues/teknik në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon që autoriteti kontraktues– **Policia e Kosovës,** ta **Anuloj** aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Jelek Anti-plumb"**me nr.prokurimi 21416 134 111, për mungesë të ofertave të përgjegjëshme, në përputhje me dispozitat e LPP-së.